



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:132917

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05532953

P.nr.1740/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e çështjes Laura Hoti Statovci me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, duke vendosur lidhur me pranimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me numër Nd.118/24 të datës 15.03.2024, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.2658/21 e datës 23.06.2021, kundër të akuzuarit R.Z., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par 6 lidhur me par 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, jashtë seancës konform nenit 229 të KPPRK-së, dhe nenit 2 lidhur me nenin 15 të Ligjit nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), Gjykata më datën 02.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I.** APROVOHET marrëveshja me nr. Nd.118/24 të datës 15.03.2024, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të akuzuarit R.Z. në njërin ane dhe të dëmtuarës K....në anën tjetër.
- II.** HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.2658/21 e datës 23.06.2021 dhe,
- III.** PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarit R. Z., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par 6 lidhur me par 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së konform nenit 229 të KPPRK-së, për shkak se i akuzuari dhe e dëmtuara, kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.2658/21 e datës 23.06.2021 kundër të akuzuarit R. Z., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par 6 lidhur me par 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, jashtë seancës konform nenit 229 të KPPRK-së.

Gjykata me datë 20.02.2024 ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale dhe me akordimin e palëve në procedurë e duke vepruar konform nenit 8 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendrën për Ndërmjetësim.

Me datë 15.03.2024 në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë është arritur marrëveshja Nd.118/24 të datës 15.03.2024 në mes të palëve në procedurë. Andaj, gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Konform nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësimin, nga data e pranimit nga gjykata, përkatësisht nga data 15.03.2024, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 248 par.1 nën par. 1.4 të KPPRK-së lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.1740/21 më datë 02.04.2024

Bashkëpunëtori profesional
Albrim Kastrati

Gjyqtarja e vetme gjyquese,
Laura Hoti Statovci

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa dhe e njëjta do ta ketë Fuqinë e titullit ekzekutiv.